

MËSIMI I GJUHËS SHQIPE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

Mediat në rolin e shkollave

**Dr. (proces) Laura PAPERANIKU BEJTULLAU, Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore &
Kulturore të Shqiptarëve, Shkup, e-mail:papraniku.laura@gmail.com**

Abstrakt

Në kontekste ku e drejta për shkollim në gjuhën shqipe mbetet e kufizuar, siç është rasti i Maqedonisë së Veriut, mediat marrin një rol të rëndësishëm kompensues, veçanërisht në fushën e mësimdhënies së gjuhës. Përtej funksionit të tyre informues, mediat në gjuhën shqipe janë përfshirë në mënyrë aktive në misionin gjuhësor dhe edukativ. Drejtuesit e “Radio Shkupit” dhe gazetës “Flaka” kanë qenë të vetëdijshëm për këtë përgjegjësi dhe shpesh kanë përdorur hapësirat mediatike si “klasa” alternative për përvetësimin e shqipes. Të dy institucionet kanë krijuar rubrika të specializuara për promovimin dhe standardizimin e gjuhës, duke ndikuar në rritjen e ndërgjegjësimit gjuhësor të publikut shqiptar. Që në vitet ’70, “Flaka” kishte themeluar rubrikën “Ç’thotë profesori i shqipes”, ndërsa “Radio Shkupi” ka transmetuar rubrikën “Si e flasim gjuhën tonë” dhe emisionin “Gjuha jonë” (2022). Këto iniciativa dëshmojnë një traditë të qëndrueshme të përdorimit të mediave në funksion të edukimit gjuhësor – një mision që vijon edhe sot.

Fjalë çelës: media; mision; gjuha shqipe; radio; gazetë; klasa alternative

Learning the Albanian Language in the Republic of North Macedonia *Media in the role of schools*

Abstract

In contexts where the right to education in the Albanian language remains limited—such as in North Macedonia—media play a vital compensatory role, particularly in the field of language instruction. Beyond their informative function, Albanian-language media have actively engaged in a linguistic and educational mission. The editors of “Radio Skopje” and the newspaper Flaka have been aware of this responsibility and have often used media platforms as alternative “classrooms” for the acquisition of the Albanian language. Both institutions have created specialized sections aimed at promoting and standardizing Albanian, significantly contributing to raising linguistic awareness among the Albanian-speaking public. As early as the 1970s, Flaka had launched the column “What the Albanian Professor Says,” while “Radio Skopje” has broadcast segments such as “How We Speak Our Language” and the program “Our Language” (2022). These initiatives demonstrate a longstanding tradition of using media as tools for linguistic education—a mission that continues to this day.

Keywords: media; mission; Albanian language; radio; newspaper; alternative classroom.

Hyrje

Sot, të gjithë bien dakord se në shoqëritë moderne roli i mediave në formimin gjuhësor të masave është i padiskutueshëm. Kur dëgjojmë radio, shohim televizor apo lexojmë gazeta përveç se marrim informacion dhe argëtohemi jemi të ekspozuar edhe ndaj fjalëve, shprehjeve dhe konstrukteve gjuhësore të gazetarëve, asaj që në teoritë e gjuhës dhe të komunikimit njihet si gjuha e gazetarëve (Rugova, 2009).

Meqenëse mediat e kanë gjuhën mjetin parësor të punës, neve prej tyre, shpesh herë mësojmë se si të flasim, se si t'i ndërtojmë fjalitë dhe se çfarë shprehjesh të përdorim për raste të caktuara. Prandaj është shumë e rëndësishme, që në radhë të parë, vetë gazetarët të zotërojnë gjuhën letrare shqipe në nivele të larta, ta flasin atë sipas rregullave të drejtshkrimit e drejtshqiptimit dhe t'i respektojnë normat e fonetikës, gramatikës, leksikut e fjalëformimit të gjuhës letrare shqipe, apo gjuhës standarde.

Në vende si Maqedonia e Veriut, ku sot e kësaj dite vazhdon të jetë e kufizuar e drejta e shkollimit në gjuhën shqipe, roli i mediave për përvetësimin e gjuhës letrare merr rëndësi të dyfishtë. Konkretisht ende nuk ka paralelet shqipe nëpër shkollat fillore të qyteteve si Velesi e Prilepi, ndërsa mungesa të shumta ka në shkollat e Manastirit, Ohrit e Prespës, si dhe në komunat e "Çuçer Sandevë"-s, "Gjorçe Petrov"-it, "Aerodrom"-it e "Butel"-it në kryeqytetin e RMV-së, në Shkup (Papraniku Bejtullau, 2022: 55-59). Në periudhën para vitit 1990 mungesa e paraleleve për mësim në gjuhën shqipe ishte ende më e madhe, pa folur pastaj për periudhën e viteve 1945-1975 (Mustafa, 1998: 79-89). Kështu mediat u është dashur sa herë të plotësojnë edhe mangësitë gjuhësore që vinin dhe vazhdojnë të vinë si pasojë e mungesës së shkollave shqipe. Në këtë këndvështrim themeluesit dhe drejtuesit e mediave të para në gjuhën shqipe në RMV, pas Luftës së Dytë Botërore, të "Radio Shkupi"-t dhe gazetës "Flaka e Vllaznimit" kanë dëshmuar se ishin të vetëdijshëm për misionin e tyre gjuhësor në shoqëri. Shpesh herë, valët e radios dhe faqet e gazetave i shndërruan në klasa për mësimin e gjuhës shqipe.

Redaktorët përgjegjës të këtyre mediave, gazetarët, spikerët dhe lektorët – të gjithë së bashku u angazhuan dhe punuan për ndërgjegjësimin gjuhësor të publikut, duke realizuar intervista, biseda dhe emisione të shumta, me qëllim të promovimit të ngjarjeve dedikuara gjuhës shqipe. E, për më tepër se kaq, shkuan përtej lajmit dhe informimit: krijuan rubrika të posaçme për mësimin e gjuhës shqipe, me karakter tërësisht pedagogjik.

Leksione për gjuhën shqipe në faqet e gazetave

Që në vitin 1970 në gazetën "Flaka e Vëllazërimit" gazetari Rexhep Zllatku do të angazhohet që përmes shtypit të shkruar të ofrojë për lexuesit e tyre mësim për gjuhën e njëzuar letrare shqipe. Gazetari arrin ta realizojë me shumë mjeshtëri idenë e tij fisnike nëpërmjet një seri shkrimesh të titulluara "Ç'thotë profesori i shqipes". Duke biseduar e duke i parashtruar pyetje gjuhëtarit Remzi Nesimit, i cili në atë kohë ishte profesor në Akademinë Pedagogjike të Shkupit, gazeta në periudhën janar – mars të po atij viti sjell për lexuesit e saj rubrikën e veçantë me leksione për mësimin e gjuhës shqipe.

Sikurse mund të shihet gazeta ka zbatuar rregullat e drejtshkrimit, para vendimeve të Kongresit i cili u mbajt në Tiranë, në vitin 1972. Forma e dikurshme e gegërishtes letrare: vllaznimi e cila lejohej me "Ortografinë e gjuhës shqipe" (1964) është zëvendësuar me formën e gjuhës së përbashkët letrare: vëllazërimin. "Pas viteve '60 'Flaka e Vëllazërimit' filloi të bëjë përpjekje serioze edhe drejt shqipes letrare të njëzuar. Kështu, ajo, para se të botoheshin 'Rregullat e drejtshkrimit të shqipes' ..., qysh më 20 nëntor 1966 fillon të dalë në gjuhën e përbashkët letrare" (Nesimi, 1997: 49). Vërehet gjithashtu se është përdorur siç duhet apostrofi te titulli i rubrikës, ndërsa për shkaqe teknike të kohës në vend të shkronjës



Ç përdoret C-ja. Diçka tjetër që duhet ta mësojnë sot një numër i madh i gazetarëve, nga kjo rubrikë, është norma drejtshkrimore se nëpër tituj gazetash a librash nuk vendoset shenja e pikësimit, pikëpyetja, edhe kur kemi të bëjmë me fjali pyetëse.

Shkrimi i parë i rubrikës “Ç’thotë profesori i shqipës” mban datën 29 kallnor (siç quhej në atë kohë muaji janar). Rubrika me profesorin është e konceptuar të jetë edhe një lloj bashkëbisedimi me lexuesit. Ajo ishte e hapur për pyetjet, vërejtjet dhe vlerësimet e lexuesve, të cilat mund t’i dërgonin në redaksinë e gazetës. Të njëjtat botoheshin dhe merrni përgjigje nga ana e profesorit. Sa i takon strukturën së shkrimeve, bie në sy që gazetari Zllatku u shmanget hyrjeve të gjata e fjalëve të tepërta. Që me fjalinë e parë, hyn drejt e në temë. Po sjellim më poshtë tekstin në origjinal, sikurse qëndron në gazetën e datës 29 janar 1970.

Pamje e shkrimit të datës 29 janar 1970, në gazetën “Flaka e vëllazërimit”

“Shpeshherë e pyes veten: Ç’është fati i gjuhës sonë letrare? Por, jo, jo kështu. Pyetja nuk është parashtruar plotësisht drejt²²⁹. Edhe diçka tjetër është pjesë e preokupimit tim (...) A duhet të flas në ambientin tim, me shokët intelektualë a të tjerë qofshin, në gjuhën e unifikuar? Apo atë t’ua lemë në pronë vetëm spikerëve, artistëve e një grusht arsimtarëve, si latinishten priftërinjë në kishë? Nuk mendoj t’ia vëndojmë vetes thikën në fyt, por, gjene*, edhe indiferenca jonë intelektuale është e dëmshme” (Zllatku, R., 29 kallnor 1970. Ç’thotë profesori i shqipës. Flaka e Vëllazërimit, Shtojca “Pegadogu”, f. 2).

Shihet qartë se gazetari zotëron nivele të larta profesionalizmi. Me një paragraf të shkurtër dhe me kaçqak fjalë, ai ka qenë në gjendje të bëjë në të njëjtën kohë gazetarin, mësuesin dhe publicistin. Gazetarin, pasi i qaset trajtimit të çështjeve që lidhen me aktualitetin, pra angazhohet të mbajë në vëmendjen e publikut nevojën për përdorimin e normave letrare të gjuhës shqipe (kjo edhe është detyra e gazetarit); mësuesin, pasi shpjegon se fjalja është ndërtuar gabimisht (forma e drejtë është: Cili është fati i gjuhës sonë letrare?) dhe publicistin, pasi krijon opinionin: shqipja letrare nuk duhet të ketë fatin e latinishtes...

²²⁹ Forma e drejtë është: **Cili është fati i gjuhës sonë letrare?** dhe jo **“Ç’është fati i gjuhës ...?”**

Ç'është vërteta rubrikën "Ç'është profesori i shqipes" nga fillimi deri në fund e karakterizon një niveli i lartë i shkrimit dhe zbatimi me përpikëri i rregullave ortografike të gjuhës shqipe. Ende më i rëndësishëm është fakti se për të shtjelluar tematikat e ndryshme nga fusha e gjuhësisë, gazetari i kërkon përgjigjet nga një specialist i fushës, i cili do të jetë në gjendje të flet me kompetencë të plotë për çështjet gjuhësore. Profesor Nesimi padyshim se ishte i tillë. Koha do të dëshmojë se ishte një pedagog i shkëlqyer, i aftë të përshtatën ligjërimin e tij si për nivelet akademike ashtu edhe për masat e gjera, varësisht nevojave dhe shtresave të cilave u drejtohej.

Gjene (po shërbehemi me shprehjen e gazetarit) kjo ishte ajo që kërkonte gazetari Zllatku. Ai kërkonte që mësimet të cilat jepeshin nga profesori nëpërmjet gazetës, të ishin të kuptueshme nga të gjitha shtresat e shoqërisë. Gazetari e shpreh hapur këtë synim kur shkruan: Profesor Remziun e luta për një gjë: të përpiket të na japë përgjigje më direkte, më praktike, të kuptueshme për një lexues të rëndomtë e të mos i ngjajë kjo bisedës akademike" (ibid). Leksionet, të cilat vijnë në formën e pyetje - përgjigjeve, i karakterizon një gjuhë e qartë dhe e kuptueshme për secilin. Çdo rregull drejtshkrimor dhe drejtshqiptimor, të gjitha normat gramatikore të diskutuara gjatë intervistave ilustron me shembuj konkret. Mund të thuhet lirisht se kjo rubrikë edhe sot, pas më shumë se gjysmë shekulli, mund të shërbejë si një kurs mësimi për çdokënd që dëshiron të merr mësim për përvetësimin e rregullave dhe normave letrare të gjuhës shqipe.

Profesor Remzi Nesimi (1933-1918) ishte gjuhëtar i niveleve të larta. Ishte jo vetëm delegat i punimeve të Kongresit të drejtshkrimit të gjuhës shqipe por dhe nënshkruar i Rezolutës së atij Kongresi që u mbajt në Tiranë në vitin 1972 (Koliqi, 2002).

Rreth konsultës gjuhësore dhe Kongresit të Drejtshkrimit

Kontribute të këtilla për gjuhën shqipe në gazetën "Flaka e vëllazërimit", sigurisht se nuk janë të rastësishme. Ato duhet konsideruar si vazhdim i një tradite që u ngjiz bashkë me themelimin e gazetës. Numri i parë i saj doli më 4 prill të vitit 1945, si organ i Lidhjes Socialiste të Popullit Punonjës të Maqedonisë. Por pavarësisht kësaj, gazetës nuk i ka munguar për asnjë moment angazhimi për t'i shërbyer ngritjes dhe zhvillimit kulturor të shqiptarëve. Në njërin prej numrave të parë të gazetës, atë të datës 23 nëntor 1945, gjejmë shkrimin me titull "Mbi një Abetar shqip" edhe atë në faqen e dytë të gazetës.

Studiuesi Sevdail Demiri në librin e tij "Shtypi shqiptar në Maqedoni (1945-1991) aspekti kulturor-arsimor", bën të ditur se shkrimi jep informacione të bollshme për gjendjen e arsimit në gjuhën shqipe në Maqedoni. Gazeta ngre si nevojë të ditës përpilimin e një Abetare e cila mungonte në atë kohë (2015:89). Në frymën e iniciativave të këtilla që ngrenë nevojën e pajisjes së shkollave me tekste mësimore të karakterit gjuhësor gjenden edhe shumë shkrime të tjera, si për shembull "Fjalorë që na duhen", i datës 11 janar 1985. Hapësirë e konsiderueshme u është dhënë ngjarjeve që kanë të bëjnë me konsolidimin e gjuhës letrare shqipe. Kështu në gazetën e datës 17 dhjetor 1953, një faqe e tërë i kushtohet Mbledhjes gjuhësore të Prishtinës që u mbajt në datat 14 dhe 15 nëntor të 1953-shit. Në njërin tekst jepen në formë integrale "Vendimet e Mbledhjes së Prishtinës" kurse në tekstin tjetër "Përshtypjet e Prof. Selman Rizës nga kjo mbledhje" (2015:98).

Një vëmendje e posaçme u është kushtuar Konsultës gjuhësore të Prishtinës (22 - 23 prill 1968) dhe Kongresit të drejtshkrimit të gjuhës shqipe që u mbajt në Tiranë (20 - 25 nëntor 1972). Në gazetën e datës 1 maj 1968, në faqen e parë të shtojcës (Formati i vogël) nga gazetari Xhevat Gega kemi kryeartikullin "Për një komb – një gjuhë letrare – një drejtshkrim", që ishte edhe motoja e atij tubimi

gjuhësor. Në të njëjtin numër gazeta nxjerr edhe pesë artikuj të tjerë edhe atë: raportimin për këtë ngjarje të gazetarit tjetër Vehap Zhitia (në faqen numër 1 dhe 6); "Konkluzat e konsultës gjuhësore" dhe "Disa fjalë mbi gjuhën letrare kombëtare shqipe" të profesorit Ali Hadri (në faqen numër 5); "Përshtypjet nga Konsulta për ortografinë e re" të profesorit Mahmud Hysa; (në faqen numër 6); "Disa çështje rreth projektit të drejtshkrimit të shqipes", nga profesor Remzi Nesimi (në faqen numër 10). Pra ngjarja është mbuluar mediatikisht me gjithsej gjashtë artikuj në shtojcën (Formati i vogël). Gazeta e datës 1 maj 1968 gjendet në Bibliotekën Kombëtare Universitare "Shën Klimendi i Ohrit" në Shkup (HYB, CV IV 226/1968).

Gazeta "Flaka e Vëllazërimit" i ka kushtuar një vëmendje të veçantë Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe, i cili u mbajt në Tiranë nga 20 deri më 25 nëntor 1972. Në numrin e datës 3 dhjetor 1972, vetëm një javë pas përfundimit të punimeve, u botua në mënyrë integrale "Rezoluta e Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe" (faqe 17–18), si dhe kumtesa e z. Remzi Nesimit me titull "Procesi i njësimimit të shqipes letrare në Maqedoni" (faqe 10). Në të njëjtin kontekst, shkrimi thekson edhe moton e gjuhëtarit Aleksandër Xhuvani: "Njësia e gjuhës asht njësia e kombit". Në numrin pasues, të datës 10 dhjetor 1972, u publikua një artikull i gjatë me titullin "Për një gjuhë kristale, stabile", ku gazetari R. Zllatku solli përshtypjet dhe reflektimet e gjuhëtarëve pjesëmarrës nga Republika Socialiste e Maqedonisë, si Dr. Petro Janura, z. Remzi Nesimi dhe prof. Sefedin Sulejmani. Më tej, më 13 dhe 15 dhjetor, gazeta botoi kumtesën e prof. Dr. Idriz Ajetit "Rruga e zhvillimit të gjuhës letrare shqipe në Kosovë", ndërsa më 24 dhjetor 1972 u publikua kumtesa "Shkrimtarët dhe gjuha letrare" e dr. Rexhep Qoses (NUB, CV IV 226/1972–IV). Vëmendja e gazetës ndaj çështjeve të gjuhës nuk u kufizua vetëm në pasqyrimin e Kongresit, por ishte evidente edhe përpara mbajtjes së tij. Kështu, në numrin e datës 22 tetor, gazetarja Naile Ajdin publikoi artikullin "Në vigjiljen e Kongresit të Drejtshkrimit. Për një gjuhë të vetme letrare", ndërsa në janar të po atij viti u botua shkrimi i gjuhëtarit Eqerem Çabej "Te burimet e shqipes". Po ashtu, gjatë muajit shkurt, në tri vazhdimë, u publikua artikulli tjetër i Çabejt "Nga historia e gjuhës shqipe, probleme dhe rezultate". Në numrin e datës 26 prill, u ribotua nga gazeta Zëri i Popullit artikulli informativ "Ç'po bëhet për hartimin e fjalorit të gjuhës së sotme shqipe". Në këtë periudhë, gazeta Flaka inauguroi edhe rubrikën e re "Çështje gjuhësore", e cila ofroi hapësirë për trajtimin e temave të ndryshme gjuhësore me interes për studiuesit e fushave si: fonetika, morfologjia, dialektologjia, leksikologjia dhe historia e gjuhës shqipe.

Arsimi dhe kultura gati gjysma e gazetës

Shkrimet dedikuar gjuhës shqipe me karakter pedagogjik e didaktik, në kuptimin e ngushtë të fjalës, nuk u kanë munguar për asnjë rast faqeve të gazetës së vetme shqipe në RMV, deri në vitin 1998. Në dekadat e fundit të shekullit XX, përveç rubrikës së lartpërmendur të gazetarit Zllatku, "Flaka e Vëllazërimit" sjell edhe fejtone me shkrime të Skënder M. Hanës. Në periudhën janar-shkurt të vitit 1972 nga ky autor gjejmë fejtonin "Roli i përsëritjes në mësimin e gjuhës shqipe" (me tre vazhdimë) si dhe shkrimin "Puna jashtë klasës në lëndën e gjuhës shqipe". Me rastin e 65 vjetorit të Kongresit të Manastirit gazetari Xh. Gega në numrin e datës 7 janar të po atij viti paraqitet me artikullin "Një vështrim rreth alfabeve të gjuhës shqipe". Në datën 9 shkurt përsëri nga S.M. Hana kemi shkrimin "Profesor Aleksandër Xhuvani-gjuhëtar dhe pedagog i dalluar", kurse në datën 18 qershor shkrimin "Norbet Jokli (1877-1942) albanolog i shquar" nga Ali Dhrimo.

Në dekadën e viteve 1980 – 1990 gjejmë fejtone si "Zhvillimi i shkronjave të para të shkrimit" me autor Nehat Hajrullarin; "Kultura e të shprehurit me gojë dhe shkrim" me autor Agim Poloska;

“Sistemi fonologjik i gjuhës shqipe”, nga profesor Ahmet Hajdari; “Teoria linguistike dhe të mësuarit” - leksione gjuhësore të Noam Çomskit; “Televizioni dhe pasqyrimi i kulturës gjuhësore” nga Qani D. Mehmedi dhe shkrime të ngjashme. Nëpër fletët e kësaj gazete janë edhe disa dhjetëra fejtone dhe qindra artikuj të tjerë përmes të cilëve jo vetëm që jepen informacione dhe mësim të vlefshme për mësimin e gjuhës letrare por, që e ngrenë lartë moralin dhe e shtojnë dashurinë për gjuhën tonë të bukur shqipe.

Fillimi i viteve të 90-ta e gjeti gazetën “Flaka” medium që shtypej tri herë në javë: të mërkurën dhe të premten (me nga 16 faqe) si dhe të dielën (me 24 faqe). Edhe pse nuk ishte gazetë e përditshme, ajo ishte një gazetë e konsoliduar dhe e mirë organizuar me rubrika të posaçme. Ballina kishte kryesisht informacione për ngjarjet kryesore politike në vend. Numrat e fundjavës (e shtunë-e diel) ishin më të pasura me informacione dhe rubrika. Në pjesën e parë gjenden rubrikat për zhvillimet politike ndërkombëtare dhe në vend, komunat, çështjet sociale dhe të shëndetit. Sakaq, në pjesë tjetër: nga faqja 14 deri 17 gjendet rubrika “Kulturë, arsim, letërsi, shkencë”; nga faqja 18 deri 21 rubrika “Shkollari” dhe nga faqja 22 deri 23 gjendet rubrika “Pedagogu”. Faqja 24 është kryesisht me informacione si: horoskopi, Programi në TV dhe Radio dhe fjalëkryqi. Pra, 10 nga 24 faqet e gazetës (41.6 %) kanë karakter kulturor – arsimor, brenda të cilave një hapësirë të konsiderueshme kanë shkrimet nga fusha e gjuhësisë, me theks të veçantë ato që trajtojnë tema nga kultura e gjuhës dhe arritjeve shkencore në këtë fushë.

Gazetarët dhe drejtuesit e gazetës vazhdimisht kanë ditur të jenë propagandues dhe nxitës të zhvillimit kulturor e arsimor të shqiptarëve në Maqedoni, por dhe më gjerë. “Flaka” kishte abonentët e saj edhe në Kosovë, Mal të Zi, Kroaci dhe Shqipëri. Në numrin festiv të datës 4 prill 1970, me rastin e 25 vjetorit të gazetës, në bisedën me kryeredaktorin e parë të saj Dr. Petro Janurën gazetari ka nënvizuar edhe një informacion interesant “Parapaguhet edhe Aleksandër Xhuvani”. Informacioni në fjalë qëndron si mes titull i shkrimit “Ditët e para të Flakës”. (HYB IV 226/70 – II).

80 vite në shërbim të edukimit gjuhësor

Misionit për përhapjen e gjuhës letrare shqipe dhe ngulitjen e normave gramatikore, sintaksore, leksikore e fjalëformuese i ka shërbyer jo pak edhe Radio Shkupi, përmes Programit të emisioneve në gjuhën shqipe që nisën të transmetohen nga 28 janari i vitit 1945. Nëpërmjet shembullit të gazetarëve, redaktorëve dhe spikerëve, se si duhet të flitet gjuha shqipe, si edhe të emisioneve nga fusha e gjuhës, kulturës dhe historisë shqiptare, për 80 vite rresht që në fillim e deri në ditët tona, ky medium është kthyer në shkollë për edukimin gjuhësor të masave. Valët e Radios depërtonin edhe në zonat më të thella të Maqedonisë, atje ku sot e kësaj dite mungojnë shkolla në gjuhën shqipe. Prandaj kontributi i Radio Shkupit në edukimin gjuhësor të shqiptarëve të RMV-së është jashtëzakonisht i madh.

Hatixhe Qulafku, e cila në vitin 1961 ishte njëra prej tre të punësuarve në Programin e emisioneve në gjuhën shqipe tregon se Radio Shkupi në atë kohë ishte një çerdhe intelektualësh. “Nëpërmjet NP ‘Nasha Kniga’ të Beogradit, si abonentë merrnin shtypin nga Shqipëria: gazetat ‘Zëri i popullit’ dhe ‘Bashkimi’, revistat ‘Drita’, ‘Nëndori’, ‘Shqiptarja e re’ dhe ‘Miqësia’. Në redaksinë e Radios mbledheshin shkrimtarë, profesorë e intelektualë. Diskutoni dhe lexoni gazetën që na vinin nga Shqipëria. Kjo e bëri Radio Shkupin, në atë kohë një fole të intelektualëve” tregon zonja Qulafku në intervistën që realizuam enkas për këtë punim më 28 tetor 2024. Prej saj mësojmë gjithashtu se, pas Parashqeva Malevskës ajo ishte ndër femrat e para gazetare të angazhuara në Radio Shkupi për emisionet në gjuhën shqipe.

Redaktor përgjegjës i programeve në gjuhën shqipe në atë kohë ishte Lutfi Rusi. Me kalimin e Rusit në gazetën "Flaka" nga mesi i vitit 1962 emisioneve të Radios u rikthehet redaktori i parë përgjegjës i emisioneve në gjuhën shqipe Murteza Peza, dhe që nga viti 1965 edhe kryeredaktori i parë i Programit të emisioneve në gjuhën shqipe dhe turke.

Radio Shkupi mori një impuls të ri zhvillimi. U zgjerua hapësira radiofonike, u shtua numri i të punësuarve dhe me këtë edhe numri i emisioneve. Pas mbajtjes të Kongresit të Drejtshkrimit (1972) profesori Remzi Nesimi, ashtu si vite përpara në "Flaka" u angazhua në përgatitjen e emisione të gjuhës shqipe, në kuadër të "Emisionit arsimor" që transmetohej ditëve të marta të javës. Sa jemi te Kongresi i Drejtshkrimit, duhet nënvizuar fakti se gazetarja Qulafku është gazetarja e parë e Maqedonisë e cila raportuar për këtë ngjarje nga Tirana, përmes linjës telefonike. "Ishte një emocion i pa përshkruar por edhe përgjegjësi profesionale të japësh lajmin për punimet e atij Kongresi, të informosh për Rezolutën, për Vendimet që u sollën aty", shprehet gazetarja (28 tetor 2024).

Emisionet e radios për gjuhën shqipe

Çështjet që lidhe me gjuhën shqipe kanë qenë çdo herë në vëmendjen e gazetarëve të Radio Shkupit. Nuk ka rubrikë dhe emision ku të mos jetë folur për gjuhën shqipe, për ngjarje dhe personalitete që me veprat e tyre bënë aq shumë për konsolidimin e gjuhës së përbashkët letrare, për zhvillimin dhe pastërtinë e gjuhës shqipe. Por një kontribut i madh për ngulitjen e normës letrare dhe përhapjen e saj është dhënë përmes emisioneve me karakter pedagogjik e didaktik. Përgatitja e emisioneve të këtilla, në formën e leksioneve të radios, nuk është ndalur për asnjë periudhë. Në periudhën e viteve 1991 - 2000 spikat rubrika "Si e flasim gjuhën tonë" e përgatitur nga gazetari Liri Lena.

Në Arkivin e emisioneve të Radio Shkupit, gjenden rreth 30 emisione të kësaj rubrike 10 – 15 minutëshe, të transmetuara herë në "Programin e hapur të mëngjesit" (6:00 h – 10.30 h) e herë në "Programin e emisioneve të pasdites" (15:30h – 16:00 h). Për shkak të cilësisë së mirë shumë prej emisioneve të rubrikës "Si e flasim gjuhën tonë" janë ritransmetuar edhe pas vitit 2000. Sipas të gjitha gjasave, duhet të ketë shkuar në mbi 120 numri i (ri)transmetimeve të emisione të kësaj rubrike, ku gazetari Lena kritikon gabimet e shumta gjuhësore të cilat i dëgjojmë prej politikanëve, gazetarëve dhe njerëzve të profesioneve të ndryshme, gjatë përditshmërisë sonë. Për të korrigjuar gabimet gjuhësore, gafat dhe skandalet, autori i rubrikës thirret në libra shkencorë, fjalorë dhe gramatika të ndryshme të gjuhës shqipe.

Shpesh herë bën edhe komente të qëlluara, që nuk i gjejmë nëpër libra. Për shembull, në njërin prej këtyre emisioneve ku trajtohet problematika e fjalëformimit në gjuhën shqipe, gazetari Lena ndalet në shprehjet e tipit: inxhinier i diplomuar; doktor i diplomuar; arkitekt i diplomuar. "Ç"kuptim ka të vendosim mbiemrin "i diplomuar" pas emrave të profesionit: inxhinier; doktor; arkitekt e kështu me radhë, përderisa nuk kemi: inxhinier i pa diplomuar; doktor i pa; arkitekt..." komenton gazetari. (Lena, L (Liri Lena), & Vllasaku, A (Ajtene Vllasaku). (2022). Si e flasim gjuhën tonë [Rubrikë e Radio Shkupit]. Shaqiri, N. (Nexhbedin Shaqiri), Si e flasim gjuhën tonë. Shkup. RMV: RTVM).

Fjalëformime si ato që u përmendën më lartë, nuk janë në natyrën e gjuhës shqipe, por fatkeqësisht kanë një përdorim të gjerë sidomos tek shqiptarët e Maqedonisë. Pra, janë forma të huazuara prej gjuhës maqedonase: дипломиран инџниер, të cilat gjithashtu janë konstrukte gjuhësore të pa nevojshme. Në rubrikën "Si e flasim gjuhën tonë" trajtohen shpesh herë huazimet e pa nevojshme (barbarizmat); shkurtesat; theksi; përdorimi i gabuar i përemrave pyetës Kush dhe Cili; përdorimi dhe mospërdorimi i apostrofit, e kështu me radhë.

Radio Shkupi i ka kontribuar kulturës gjuhësore, e me theks të veçantë dashurisë dhe ngritjes të vetëdijes gjuhësore e kombëtare edhe nëpërmjet emisioneve e rubrikave të tjera. Përmendim këtu emisionet javore: “Mikrofoni i hapur”; “Mozaiku kulturor”, “Emisioni arsimor”, “Pa kufi”, e ndonjë tjetër ku studiuesit dhe profesorët e gjuhës janë ftuar rregullisht të flasin për çështje që kanë të bëjnë me gjuhën shqipe, problemet dhe sfidat e saj. Tradita e emisioneve të karakterit arsimor vazhdon edhe sot e kësaj dite. Jo më larg se viti 2023, në Radio Shkupi u përgatitë një seri emisionesh të titulluara “Gjuha jonë”. Profesorët universitar Asllan Hamiti, Ismet Osmani dhe Zeqir Kadriu brenda formatit: profesori ju tregon, ligjëronin rreth problematikave të ndryshme nga fonetika, gramatika, leksiku, fjalëformimi, si dhe drejtshkrimi dhe drejtshqiptimi i gjuhës shqipe.

Konkluzione

Çështjet gjuhësore kanë qenë çdo herë në vëmendjen e medimeve në gjuhën shqipe në RMV, që prej themelimit të mediave të para, pas LDB-së, të “Radio Shkupi”-t dhe gazetës “Flaka e vallëzimit”. Angazhimi i mediave për të mbajtur në qendër të vëmendjes së publikut çështjet që kanë të bëjnë me gjuhën shqipe i ka kontribuar jashtëzakonisht shumë ngritjes së vetëdijes gjuhësore. Emisionet dhe rubrikat e shumta, për dhe rreth çështjeve të shqipes letrare, i kanë ndikuar pozitivisht në zhvillimin e kulturës gjuhësore në mesin e shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut. Trajtimi i çështjeve gjuhësore nga ana e mediave nuk ka qenë i rastësishëm por i planifikuar dhe i mirë organizuar. Për këtë flasin rubrikat e karakterit tërësisht arsimor si dhe përgatitja e emisioneve nga zhanre të ndryshme të gazetarisë së shkruar dhe radiofonike. “Radio Shkupi” dhe “Flaka” shpesh herë i kanë shndërruar valët e radios dhe faqet e gazetave në “klasa” për mësimin e normës letrare të gjuhës shqipe. Tradita e emisioneve dhe rubrikave të posaçme për mësimin e gjuhës letrare shqipe vazhdo edhe sot e kësaj dite.

Referenca

- Demiri, S. (2015). *Shtypi shqiptar në Maqedoni (1945–1991): Aspekti kulturor-arsimor*. Shkup: ITSHKSH.
- Ibrahimi, Z. (Ed.). (2019). *Remzi Nesimi për gjuhën shqipe*. Shkup: ITSHKSH.
- Koliqi, H. (2002). *Historia e arsimit dhe e mendimit pedagogjik shqiptar*. Prishtinë: Libri Shkollor.
- Mustafa, A. (1998). *Zhvillimi i shkollës fillore shqipe në Republikën e Maqedonisë 1945–1975*. Shkup: Logos-A.
- Nesimi, R. (1997). *Çështje gjuhësore*. Shkup: SHB “Shkupi”.
- Papraniku Bejtullau, L. (2022). *Pabarazia në arsim*. Shkup.
- Rugova, B. (2009). *Gjuha e gazetave*. Prishtinë: KOHA, Biblioteka URB.
- Sinani, A. (2024, June 6). Kongresi i Manastirit – 116 vite nga alfabeti që na bashkoi: Dokumente arkivore, artikuj dhe fotografi. Monografi Akademike Shqiptare.
- Burime arkivore
- Biblioteka Kombëtare Universitare “Sh. Kimendi i Ohrit”, Shkup – Arkiva e gazetës Flaka e vëllazërimit dhe Flaka: CV IV 226/45; CV IV 226/68; CV IV 226/70; CV IV 226/72 – I, IV
- Intervistë
- Qulafku, H. (2024, October 28). Intervistë për “Radio Shkupi” (periudha 1961–1993). Intervistuar nga [emri i intervistuesit, nëse dëshiron ta përfshish].